



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 25 Mars 2023

Nr: 207

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**EMËRIM TË ANËTARËVE TË KZAZ NR. 01, BASHKIA MALËSI E MADHE, TË PROPOZUAR NGA
PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 7, të Vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N :

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë me shkresën nr. 468/2 prot., datë 13.03.2023, ka kërkuar emërimin e tre anëtarëve në KZAZ nr. 1, bashkia Malësi e Madhe.

Pas kryerjes së verifikimit të dokumentacionit, me plotësimin të tij, dhe verifikimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezultojnë që propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Data: 25 Mars 2023

Nr:207

Ora: 12:00.



“Për emërim të anëtarëve të KZAZ-së nr.01, bashkia Malësi e Madhe, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023”

V E N D O S:

1. Të emëroj anëtarët e KZAZ-ve nr. 01, z. Florjan Kolë Uldedaj, z. Ramazan Agim Culaj, dhe z. Rigers Gjonarin Lulati, bashkia Malësi e Madhe, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen e KQZ-së dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: .. 03 2023 Nr:
Ora:



“Për emërim të anëtarëve të KZAZ-së nr.01, bashkia Malësi e Madhe, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023”